REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 213/19
Datë/Datum. 24.05.2019
PRISHTINE - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e Prokurimit Komuna e Prishtinës	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Agim Sheqiri – Ekspert Shqyrtues i prokurimit.		
Lënda:	Raporti i Ekspertit Shqyrtues, lidhur me ankesën me nr. 213/19 të parashtruar nga OE."Toifor".-Prishtinë		
Datë	24.05.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin lidhur me ankesën e datës 15.05.2019 me nr. 213/19 të parashtruar nga "OE." Toifor" Prishtinë për Lot 3 për aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve , debllokimi i kanalizimit atmosferik " i ndarë në 6 llote me nr. prokurimi **616-18-440-2-1-1** i realizuar nga Komuna e Prishtinës .

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të Ekspertit Shqyrtues të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e Ekspertit Shqyrtues.
Ti dorëzohet:

- OE ankues
- Autoritetit Kontraktues- Komuna e Prishtinës
- Panelit Shqyrtues – OSHP

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

		17.05.2019	24.05.2019
Nënshkrimi i ekspertit		data e autorizimit të ekspertit.	data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 15.05. 2019 OE. "Toifor", " ka parashtruar ankesë për lot 3 për aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve, debllokomi i kanalizimit atmosferik " i ndarë në 6 llote me nr. prokurimi **616-18-440-2-1-1** -1 i realizuar nga Komuna e Prishtinës .
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues

Pretendimet ankimore

Pretendimet ankimore të OE "Toifor"-Prishtinë

Njoftim për kontratë:27.08.2018
Data e hapjes se ofertave: 13.11.2018
Leter per tenderusin e suksesshëm, Loto 3, e datës: 10.12.2018
Njoftim ne kthim per rivlerësim te dates : 18.12.2018
Leter standarde per tenderusin e eliminuar te datës: 25.01.2019
Kërkesë per qasje në dokument zyrtare :30.01.2019
Kërkesë për rivlerësim, datë: 30.01.2019
Vendimi i ri i vlersimit te datës: 04.02.2019
Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm, datë: 26.04.2019
Kerkesë per qasje në dokument zyrtare :30.04.2019
Kërkesë për rivlerësim, datë: 02.05.2019
Vendimi i rivlerësimit nga AK, datë 06.05.2019

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

- Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti,
- Neni 7, Barazia në trajtim /jo diskriminim,
- Neni 52, Kriteret për dhënien e kontratës,
- Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,
- Neni 69, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale,
- Depozitat e vendimit të PSH nr 61,62 dhe 65/19 te datës 27.03.2019

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Pas parashtrimi te ankesës ne as qe jemi njoftuar lidhur me pezullimin e aktiviteti te prokurimit por me pas kemi pranuar njoftimin se loti tre pas procesit te rivlerësimit është anuluar komplet si i tillë me arsyetimin se nuk ka pasuar oferta të përgjegjshme.

Ne fillimisht ju kemi drejtuar AK-së por ankesa jone është refuzuar gjoja se nuk jemi te përgjegjshëm , por pas parashtrimit te ankesës ne OSHP është vërtetuar se ne i plotësojmë kriteret e kërkuara për vlerësim , por tani ne nuk rekomandohemi për kontrate per llot 3 por për llot 1. Per kontratë per llot 3 rekomandohet OE "Dardania" i cili fillimisht ne vlerësimin e pare, me date 10.12.2018 nuk është rekoamanduar për asnjë prej lotëve te publikuara. Çmimi ynë është 409.969.006 ndërsa i OE Dardania 413.301.276 e cila, pas kërkesës për rishqyrtim, rekomandohet per llot 1. Nëse i mermi për bazë mënyrën e vlerësimit shihet qarte se OE Dardania i keni krijuar favore te caktuara pasi qe fillimisht nuk rekomandohet fare , me pas rekomandohet per llor 1 ndërsa përfundimit ne rivlerësimin e trete rekomandohet per llot 3. Në këtë llot ne jemi te vetmit pretendent per kontrate pasi qe plotësojmë kushtet e kërkuara kualifikuese dhe ofrojmë çmim me te lire.
Neni9
Rivlerësimi i ofertave nuk është bere ne përputhje me kriteret e kërkuara pasi qe, ne konsiderojmë se OE i rekomanduar per llot 3 nuk i plotëson kërkesat qe lidhen me pajisje. Kjo tregon se AK ka qenë subjektiv gjatë rivlerësimi te ofertave pasi qe per llot 3 rekomandon OE te pa përgjegjshëm . Për te vërtetuar ketë referojuni vlerësimeve paraprak dhe Ofertës se OE te rekomanduar per kontrate per llot 3 (tre), per herën e fundit.

Nenin 69
OE i rekomanduar nuk plotëson kapacitetin teknik dhe profesinal qe ka te bej me makinerinë e kërkuar dhe kjo është konstatuar edhe ne vlerësimet paraprake kur OE i rekomanduar për kontratë për lot 3 fillimisht nuk është rekomanduar per kontrate për asnjë llot , pastaj është rekomanduar per llot 1 pasi qe nuk ka plotësuar kapacitetet per llot 3 sepse ky llot kërkon numrin me te madh te makinerive.

Ne kërkojmë nga AK qe te bëjë verifikim e pajisjeve qe ka te beje me numrin e cistemave

(cistemat me targa 631-KS-226 dhe me targa 01-443-LA) Këto cistema nuk e plotsojne kriterin e kërkuar, në dosjen e tenderit, me kapacitet min 7.0m^3. Pajisjet e pretenduara e kanë kapacitetin më të vogël se 7m^3.
Ndërsa pajisjet tjera të prezantuar me video inçizim nga Republika e Shqipërisë nuk janë argument ligjor e as faktik. Paraqesin diskriminim për OE tjerë të cilët i kanë dokumentuar me të gjitha dokumentet dhe prezencen fizike të tyre, për të cilat edhe kanë shpenzuar për tu pajisur me dokumentet valide, të qarkullimit rrugor, të Republikës së Kosovës. Bashkëlidhur më këtë shkresë po iu paraqesim një pajisje speciale, sipas kërkesave të dosjes së tenderit për kryerjen e punëve të kërkuara, e dokumentuar me dokumentacionin përkatës zyrtar.
OE "Dardania" ka paraqit një pajisje me targa 01-245-LA për të cilën pretendon që është cisternc me mekanizem komplet për pastrimin dhe debllokimin e ujëmbledhësave të kanalizimit atmosferik që në të vërtetë kjo është kamionetë e pajisur me mekanizem vptëm për debllokim të kanalizimit atmosferik.
OE "Dardania" për makinë fshirëse speciale për fshirjen e fshesheve ka paraqitur kamionin për fshirjen e rrugëve me targa 01-956-HM i cili është i dedikuar për pastrimin, fshirjen e sipërfaqeve të vrazhda gjatë kryerjes së punëve ndërtimore të asfaltbetonit.
Ne jemi te bindur se OE i rekomanduar nuk posedon numrin c pajisjeve dhe kjo fillimisht është vetëtuar edhe nga vet AK , por tani rezulton se i plotëson.
Te vërtetohet makineria qe ka te bëje me cistcmat e kërkuar dhe si dhe makineria qe lidhe me fshisat speciale dhe fshesë për pastrim te sheshit , pasi qe OE te rekomandua rimungojnë , sepse AK mund te katë marre për baze dokumente qe nuk janë te vlefshme.
Ne si OE parashtrojmë ankese për lotin nr. 3 ku fillimisht ishim te rekomanduar per kontrate , me pas është anuluar krejtësisht ky llot dhe ne baze te vendimit te OSHP rezulton qe ne jemi te përgjegjshëm por tani formula e AK ndryshon dhe tendencat e këtij vlerësimi janë te qarta për OE Dardania i cili nuk plotëson kriteret kualifikuese dhe arrin te rekomandohet per kontratë per lotin i cili kërkon numrin me te madh te automjete lidhur me pastrimin dhe de bllokimin e rrugëve dhe kanalizimeve.
Ne presim qe AK te reflektoj se pse edhe ne rivlerësimin e tretë nga ne janë kërkuar informata sqaruese vetëm per llot 3 dhe ne kemi arritur te sigurojmë çdo dëshmi te kërkuar , per me tepër posedoni shkresat dhe korrespondencat tona ne raport me ju andaj kërkojmë qe ku aktivitet i prokurimit per llotin nr 3 te rivlerësohet sepse AK ka rekomandua për kontratë OE te papërgjegjshëm.

-Pas kërkesës per rishqyrtim nga OE Dardania te datës 14.12. 2018 dhe vendimit AK te dates 18.12.2018 eshte vendosur qe lënda te kthehet ne rivlersim per te gjitha llotet me arsyetimin e gjetjes se kombinimit me te lire ku pas shpalljes se fitusve te njoftimit te datës 26.04.2019 nuk rezullton qe te jete çmimi me i lire sipas kombinimit.

Arsyetimi i dhënë në Vendimin e AK, për rivlerësim, të datës 06.05.2019 rezulton që OE "VEMOR" është deklaruar për vazhdimin e vlefshmërisë së tenderit vetëm për pjesën 6. Ky OE nuk është trajtuar si i përgjegjshëm për pjesët tjera, kurse në LS për njoftimin e dhënjes së kontratës së datës 26.04.2019 është trajtuar si i pasuksesshëm për Lot 1, 2; ndërsa për lot 5 është eliminuar.
Si është e mundur që OE është vlerësuar për Lot 1 dhe 2 si i përgjegjshëm por për shkak të kombinimeve (çmimi i tërësishëm më i ultë) është rekomanduar për Loto 6. Nga kjo rezulton se kombinimi ka mundur të bëhet edhe për loto të tjera si shembulli i mëposhtëm

Rezultati nga AK

Lote 1	TOIFOR	214827.10 EURO
Lote 2	EL-BAU	245418.44 EURO
Lote 3	DARDANIA	413301.27 EURO
Lote 4	NITI-MILENIUM	194391.28 EURO
Lote 5	ZAHIRI	213680.72 EURO
Lote 6	VEMORI	257543.06 EURO
Totali		1,539.161.87

Lote 1	VEMORI	179398.59 EURO
Lote 2	DARDANIA	250976.32 EURO
Lote 3	TOIFOR	409969.38 EURO
Lote 4	NITI-MILENIUM	194391.28 EURO
Lote 5	ZAHIRI	213680.72 EURO
Lote 6	EL-BAU	283927.96 EURO
Totali		1,532,334.25 EURO

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë: 27.08.2018

Lloji i procedurës së aplikuar:.....Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:..... Kontratë për shërbime me vlerë të madhe

Vlera e parashikuar e kontratës:..... 1,650.000.00 €

Kriteri për dhënie të kontratës(N.52)..... tenderi i përgjegjshëm me çmim më

të ulët, numri maksimal i lotev të shpërblyera është një (1)	
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.	13.11. 2018
Data e hapjes së ofertave	13.11.2018
Data e përfundimit të ri- vlerësimit të ofertave	26.04.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim..... me datë 02.05.2019 janë parashtruar Kërkesa për Rishqyrtim nga OE "Toifor ", ndërsa me datë 06.05.2019 Autoritetit Kontraktues përmes vendimit ankesat refuzohen të pa bazuara.	

Kriteret për kualifikim:

II.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Deklaratë nën betim – Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklarata nën betim e nënshkruar dhe vulosur nga tenderuesi (duhet dorëzuar së bashku me tenderin). Dëshmitë tjera lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkohen nga tenderuesi të cilit Autoriteti Kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet .
2. Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon:

   a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,c,d, edhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga Gjykata Kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit- Vërtimin nga Gjykata Ekonomike - për tenderuesin e propozuar për dhënie të kontratës

   b. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të

vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës] – Vërtetimin nga ATK-ja për tenderuesin e propozuar për dhënie të kontratës. Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale.

1. Kërkesa: Certifikatë e regjistrimit të biznesit ,regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj te themelimit.
2. Kërkesa: Certifikatë e numrit fiskal .

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Dëshmia: Te dëshmohet me Certifikatë te Regjistrimit te Biznesit si dhe me informacione te biznesit-Kopje.
2. 2Dëshmia: Certifikatë te Numrit Fiskal- Kopje

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
N/A

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. OE-ik duhet te ofroj dëshmi te mjaftueshme se ka realizuar kontrata për shërbime te ngjashme ne tri vitet e fundit nga koha e publikimit të këtij Njoftimi per Kontratë - në vlerën minimale prej 150,000.00 euro për pjesë (Lot) Shënim: Ne rast se operatori ekonomik dorëzon tender për me shume se 1 pjesë (lote) minimumi i shërbimeve te ngjashme qe kërkohet është 150,000.00 euro meqenëse ai do te shpërblehet maksimum për 1 Lot.

2. OE – duhet te ketë stafin profesional: - Një inxhinier apo bachelor te ndërtimtarisë apo komunikacionit me tri vite pervoje pune. - për pjesën e I-re Punëtor fizik– minimum 25 punëtor - për pjesën e II-re Punëtor fizik – minimum 25 punëtor - për pjesën e III-te Punëtor fizik – minimum nga 35 punëtor - për pjesën e IV-te Punëtor fizik – minimum nga 25 punëtor - për pjesën e V-te Punëtor fizik – minimum nga 25 punëtor - për pjesën e VI-te Punëtor fizik – minimum nga 30 punëtor

3. OE – duhet te ofroj dëshmi qe posedon apo ka ne shfrytëzim pajisjet e pershkruara në Aneksin 7 te dosjes se tenderit

Dëshmitë e dokumentuara.

1. Lista e projekteve të realizuara në tre vitet e fundit për kontratat e realizuara për shërbime te ngjashme duke plotesuar Aneksin 6, dëshmuar me kopjet e referencave apo certifikatave te pranimeve
2. Per inxhinierin apo bachelorin e ndërtimtarisë apo komunikacionit si dëshmi duhet

dorëzuar kopjen e diplomës dhe CV , ndërsa për punëtoret tjerë deklaratë se nëse OE është i fitues i tenderit do te angazhoj numrin e punëtorëve të kërkuar sipas pjesëve (Loteve).

3. Listën e pajisjeve me dëshmitë: DUD-at për ato automjete qe nuk kane librezë te qarkullimit, Librezat e qarkullimit. Nëse mjetet janë në shfrytëzim kontratat për shfrytëzimin e tyre

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike

Nr	Operatorët Ekonomik	Vendi	Lotet	Çmimi për Llot në €
1	"Dardania "	Prishtinë	I II III IV V VI	261,722.50 250,976.00 413,301.27 290,277.02 241,942.18 412,121.13
2.	"VZ Company"	Prishtinë	I II III IV V VI	218,073.66 228,765.16 448,549.24 201,312.65 - 379,223.77
3.	"Zahiri "	Prishtinë	I II III IV V VI	213,680..72
4.	"Niti-N&Milenium Konstruction"	Prishtinë	I II III IV V VI	233,160.50 402,309.82 458,914.96 194,391.28 358,946.38
5.	"Toifor"	Prishtinë	I II III IV V VI	214,827.87 226,799.24 409,969.38 204,431.60 - 381,744.82
6	"Ve-mor"	Pejë	I	179,397.59

			II III IV V VI	210,174.40 - - 317,742.63 257,542.04
7.	"Pastrimi"	Prishtinë	I II III IV V VI	126,565.44 127,769.94 191,614.30 149,815.18 - 233.105.90
8.	"El-bau"	Gjilan	I II III IV V VI	233,105.90 245,418.44 - 235959.98 257,198.00 283,927.96

Komisioni vlerësues pranë AK:

Pas vendimi të Panelit Shqyrtues nr .61,62 dhe 65/2019 të datës 27.03.2019 AK ka rivlerësuar ofertat dhe për kontratë ka rekomanduar operatoret ekonomik si ne vijim:

Lot 1	"TOIFOR"	214,827.10 EURO
Lot 2	"EL-BAU"	245,418.44 EURO
Lot 3	"DARDANIA"	413,301.27 EURO
Lot 4	"NITI-MILENIUM"	194,391.00 EURO
Lot 5	"ZAHIRI"	213,680.72 EURO
Lot 6	"VEMORI	257,543.06 EURO

Përgjigjeje në pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues :

Sqarim Hyrës

Ky aktivitet i prokurimit është vlerësuar tri herë nga ana e AK-së, dhe fillimisht për kontratë për llot III është rekomanduar OE." Toifor", por ky rekomandim është anuluar edhe pse për ketë llot nuk ka pasur Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-së, dhe as ankesë në OSHP.

Autoriteti Kontraktues fillimisht për kontratë ka rekomanduar OE si në vijim:

1. Lot 1 OE."Ve-mor" me çmim prej 179,398.05 €
2. Lot 2 OE."Pastrimi" me çmim prej 126,975.14€
3. Lot 3 OE " OE. Toifor " me çmim prej 409,969.38€
4. Lot 4 OE."Niti-N& Milenium Konstruction" me çmim prej 194,391.65€
5. Lot 5 OE."Zahiri" me çmim prej 213,680.72€
6. Lot 6 OE "El Bau" me çmim prej 283,927.96€

Operatori Ekonomik "Dardania " në vlerësimin e parë të ofertave nuk është rekomanduar për asnjë llot, ndërsa pas Kërkesës për Rishqyrtim AK i kishte rivlerësuar ofertat dhe OE."Dardania" e kishte rekomanduar për llot I me çmim prej 261,722.50 €, ndërsa fillimisht për ketë llot ka qenë i rekomanduar OE."Ve-mor" me çmim prej 179,398.05 €

Rekomandimi për kontratë për llote sipas vlerësimi te datës 25.01.2019 ishin si ne vijim:

1. Lot 1 OE." Dardania" me çmim prej 261,722.50€
2. Lot 2 OE."El bau" me çmim prej 245,418.44 €
3. Lot 3 - Anulohet
4. Lot 4 OE. "Niti-N&Milenium Konstruction" me çmim 194,391.28€
5. Lot 5 OE,"Zahiri" me çmim prej 213,680.72€
6. Lot 6 - Anulohet

Autoriteti Kontraktues pas Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruar nga OE." Dardania" për LOT 1,2,4 dhe 6 llotin nr. 3 e kishte anuluar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së.

Në lotin nr 3 nuk ka pas ankesë dhe as kërkesë për rishqyrtim, dhe AK pas marrjes se vendimit për shpërblim për kontratë nga OE te rekomanduar kishte kërkuar vërtetimi nga gjykata , ATK-ja dhe sigurimin e ekzekutimi të kontratës .

AK lidhur me anulimin e lloteve 3dhe 6 edhe pse nuk ka pas ankesë apo Kërkese për Rishqyrtim është arsyetuar gjoja është i nevojshëm kombinimi i lloteve , por në fakt një gjë e tillë nuk ka ndodh, dhe me këtë rast AK e ka pas të qartë se vet ndarja e tenderit në llote nënkupton se çdo llot i ndare është kontrate në vete, që do te thotë se parashtrim i një ankese ne llotet tjera nuk nënkupton anulim të lloteve ku nuk është parashtruar ankesë eventuale nga ana e ndonjë ofertuesi-pjesëmarrësi të pakënaqur në tender.

Rezultatet e ri-vlerësimit kane treguar se në katër llotot e rivlerësuar duke përjashtuar llotet III dhe VI oferta totale e për llotet e rekomanduara kishte arritur të jetë mbi 200 mijë Euro me e lartë se sa që ishte nga vlerësimi fillestar i AK-së.

Pas vendimit të Panelit Shqyrtues të datës 27.03.2019 Autoriteti Kontraktues OE. "Toifor" e

rekomandon për kontrate per LLot I ndërsa për llot III e rekomandon OE "Dardania " , me çmim prej 413,301.27 Euro, edhe pse OE."Tofor kishte çmim 409,969.38 Euro, dhe fillimisht nga vet AK ishte rekomanduar për ketë llot.

Përgjigjeje në pretendimet ankimore të OE."Toifor"

OE ."Toifor" fillimisht kualifikohet i përgjegjshëm dhe rekomandohet për kontratë për Llot 3, por pas Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruar nga OE "Dardania" për llotet 1,2,4 dhe 6 Autoriteti Kontraktues pa ndonjë arsyetim e anulon llotin 3, qe do te thotë se pa u plotësuar asnjë dispozitë e nenit 62 te LPP-së.

Sipas raportit të vlerësimit të datës 25.04.2019 OE."Dardania " rekomandohet per lot III, ndërsa OE ankues për LLot I

Duke u bazuar në pretendimet ankimore Eksperti Shqyrtues lidhur pretendimet ankimore konstaton si në vijim:

- Gjatë këtij aktiviteti të prokurimit vlerësimi nuk ka qenë ne përputhje me nenin 7 të LPP-së, pasi qe tri here është vlerësuar aktiviteti i prokurimit dhe rezultatet e vlerësimit ndryshojnë duke u thirrur në parimin ekonomicitetit, por nëse marrim për bazë totalin e ofertave dhe mënyrën e vlerësimit të këtij aktiviteti t ë prokurimit atëherë nuk kemi të bëjmë me parimet bazë të LPP-së.
- Vlerësimi i ofertave nuk është bërë në përpudhje me nenin 59 te LPP-se pasi që pajisjet e ofruara të OE." Dardania " nuk plotësojnë kërkesat e parashtruara në njoftim për kontratë dhe në dosje të tenderit, dhe ketë e dëshmojnë edhe raportet e vlerësimet të ofertave për këtë aktivitet të prokurimit ku fillimisht A K për llot 3 rekomandon OE "Toifor", ndërsa OE "Dardania" nuk e rekomandon për asnjë llot. Në rivlerësimin e dyte AK e anulon ketë lot me arsyetimin s e nuk ka ofertues të përgjegjshëm ndërsa për herën e tretë e rekomandon OE."Dardania"
- Pretendimi ankimor lidhur mos respektimin e nenit 69 të LPP-së janë të bazuara pasi makineria e ofruar nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit.
  Kërkesa për 4 cisterna nuk është plotësuar pasi në dosje janë kërkuar 4 cisterna me kapacitet $7m^3$ ndërsa OE i rekomanduar ofron dëshmi vetëm për tri cisterna .Lidhur me këto makineri OE i rekomanduar ofron një kontratë me për marrje ,me qira ku për pozicionin e cisternave tri makineri janë në pronësi të qiramarrësit dhe ne bazë të dëshmive dy nuk figurojnë se janë cisterna (atobota) për larje te rrugëve për ne te dhënat e tyre flasin se janë kamion mbi 18 ton ,vetëm cisterna me nr. AA149-NS në librezën e qarkullimit shkruan se është bote për larjen e rrugëve , ndërsa dy makineritë tjera me nr.

regjistrimiAA629RD dhe AA453MS kane përshkrimin kamion mbi 18 tonë qe do te thotë se nuk janë makineri për larje te rrugëve . Makineritë qe janë marre me qira faktikisht janë marrë si të vlefshme përmes video incizimeve , por jo përmes gjendjes se vërtetuar me rastin e vizitës ne teren të bërë nga ana e AK-së

Sipas librezave të qarkullimit automjet me nr. regjistrimi 631-KS-226 dhe automjeti me targa 01-443-LA nuk kanë përshkrim se janë automjete (cisterna apo autobota) për larje të rrugëve por janë automjete për transportim të ujit

Makineria e prezantuar me nr. regjistrimi 01-245-LA nuk plotëson kërkesat e dosjes se tenderit pasi nuk kemi të bëjmë me cisternë për debllokim ujëmbledhësve dhe ujërave atmosferike por kemi te bej me një makineri që në librezë te qarkullimit ka përshkrimin furgon për pastrim te kanalizimeve, që do te thotë se nuk kemi të bëjmë me asnjë lloj cisterne e cila është kërkuar në dosje te tenderit.

Tek aneksi 7 pajisjet e duhura është kërkuar qe OE per llot 3 duhet t e posedojnë 2 makina fshirëse speciale për trotuare dhe një makinë për pastrim të sheshit dhe sipas ofertës OE i rekomanduar për kontratë për ketë pozicion ofron dëshmi vetëm për një makinë speciale për pastrim te sheshit e cila dëshmohet me libreze qarkullimi, dhe për ketë OE ankues ka ngritur pretendim se makina e tillë nuk është për pastrim te shesheve, por eksperti ne ketë qeshje nuk mund të jap vlerësim se është makineria adekuate pasi qe vet kërkesat e dosjes nuk e kanë precizuar se çfarë tipi, lloj, madhësie apo çka duhet të përmbajnë makineritë apo çfarë duhet te jenë ato fshesa.

Lidhur me fshesat speciale për pastrim të trotuareve OE i rekomanduar nuk ofron libreza qarkullimi por ofron kontrata t e shitblerjes ndërsa ne dosje te tenderit shume qartë theksohet se DUD-at kërkohen për ato automjete qe nuk kane librezë te qarkullimit, makineritë e tilla domsdoshmerisht duhet te kenë librezë qarkullim për ti konsideruar të pranueshme pasi janë makineri qe dalin ne komunikacion, ndërsa DUD kërkohen për makineritë qe qëndrojnë brenda vend punishteve dhe nuk kane dalje ne rrugë-komunikacion, dhe në dosje shprehimisht është kërkuar librezë qarkullim ndërsa për makineritë qe nuk kane libreze qarkullimi DUD doganor.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK vlerësimin ofertave për ketë aktivitet të prokurimit nuk e ka bërë në përputhje me dispozitat dhe parimet e LPP-së , dhe ketë e argumenton fakti se OE. "Dardania" fillimisht nuk është rekomanduar për asnjë llot, me pas është rekomanduar per llot 1(një) me arsyetimin se për ketë llot plotëson kërkesat e dosjes , dhe ne fund është rekomanduar per llot III.

Shkeljet e konstatuara të LPP-së

AK gjatë zbatimit të këtij aktiviteti të prokurimit AK nuk ka respektuar nenin 7 që ka të bëjë me favorizim/mos diskriminim, nenin 59 vlerësimi dhe krahasimi i ofertave , dhe nenin 69 të LPP-së që ka të bëjë me kapacitetin teknik dhe profesional,

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimore të OE ankues "Toifor" janë të bazuara, andaj rekomandon që lënda për Lot 3 te kthehet në ri- vlerësim.